



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË

Mesazhi i Ministrit



Objektivat themelore për bujqësinë do të njohin hapa të rëndësishme në vitin e dytë të zbatimit të Programit të Qeverisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Rritja e produktivitetit dhe e aftësisë konkurruese të bujqësisë, përmirësimi i standarteve si dhe garantimi i sigurisë ushqimore, përbëjnë sfidat tona më të rëndësishme për vitin 2007 e në vazhdim.

Specializimi i prodhimit në sektorët e perimeve, vreshtarisë, frutikulturës dhe blegtorisë, përmirësimi i rrjetit të marketingut dhe plotësimi i standarteve të sigurisë ushqimore mbeten në themel të angazhimeve për strukturat e Bujqësisë Shqiptare.

Rritja e shkallës së mbështetjes financiare të bujqësisë dhe agroindustrisë (kreditim, skema mbështetje specifike, etj.). Në këtë kuadër, skemat e mbështetjes financiare për vreshtarinë dhe pemtarinë përbëjnë një risi të rëndësishme që zë fill në vitin 2007 në politikat tona bujqësore.

Rritja e aftësisë konkurruese të produkteve vendase bujqësore kërkon ndërhyrje të rëndësishme për përmirësimin, e shërbimeve dhe infrastrukturës së marketingut për rritjen e aksesit të fermerëve në treg, si dhe përmirësimin e menaxhimit të skemave të ujitjes dhe kullimit në të gjithë vendin.

Nxitja e kooperimit si dhe përmirësimi dhe transferimi i teknologjive në prodhim e agropërpunim do të përbëjnë objektiva të tjerë permanentë të institucionit tonë në funksion të rritjes së efektivitetit në bujqësi.

MINISTRI
Jemin GJANA

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Jemin Gjana', written over the printed name and title.

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	3
3	Programet buxhetore të Ministrisë	5
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	6
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	11
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	12
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë	13
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin European	15
Aneks 4	Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO... Error! Bookmark not defined.	
Aneks 5	Investimet publike	16
Aneks 6	Projekte të ndihmës së huaj	17

1 Misioni i Ministrisë

Misioni i MBUMK është zbatimi i Programit të Qeverisë në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Elementet bazë të këtij misioni janë:

- Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit
- Mbrojtja e shëndetit të kafshëve, bimëve dhe garantimi i shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që rrjedhin prej kafshëve dhe cilësia e ushqimeve
- Sigurimi i informacionit bujqësor
- Menaxhimi dhe administrimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore
- Asistencë dhe informacion për fermerët
- Menaxhim i sistemit të kullimit dhe koordinimi i veprimeve për administrimin e sistemit të ujitjes

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe ushqimit

Strategjia sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit, si çdo strategji tjetër, duhet të pasqyrojë: (i) Programin e qeverisë; (ii) Integrimin europian dhe euro-atlantik, që do të thotë zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe planin e anëtarësimit në NATO; (iii) Investimet publike dhe asistencën e huaj. Përveç kontributit për SKZHI-në, strategjia sektoriale ka për qëllim të vendosë lidhje midis objektivave strategjike, me një perspektivë shtatë vjeçare, dhe programeve të shpenzimeve të hartuara në kuadrin e PBA-së. Qëllimet e tjera të strategjisë janë: (i) të sigurojë koherencën e politikave dhe sensin e orientimit afatgjatë të zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe ushqimit; (ii) të krijojë qartësi në lidhje me reformat dhe proceset e zhvillimit që ndodhin në sektorin publik dhe privat.

Strategjia ndërsektoriale e zhvillimit rural

Strategjia kombëtare për zhvillimin rural (SKZHR) përshkruan prioritetet e politikës së zhvillimit rural të vendit, të cilat janë përcaktuar në një linjë të plotë me prioritetet e Qeverisë si dhe të Komunitetit Europian, mbi politikën e zhvillimit rural. SKZHR do të shtrihet gjatë periudhës së viteve 2007-2013, dhe do të përfshijë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Objektivat kryesorë në këtë fushë janë: (i) Planifikimi dhe zbatimi i planeve të veprimit nëpërmjet zbatimit të projekteve pilote rajonale të zhvillimit, si dhe zgjedhjen e zonave premtuese rurale pilote për zhvillimin rural; dhe (ii) Ritja e kreditimit në masën 6% në zonat rurale për mekanizimin, frutikulturën, vreshtarinë dhe inputet.

Strategjia ndërsektoriale e mbrojtjes së konsumatorit

Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorit është duke u përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrinë e Shëndetësisë si dhe Departamentin e Koordinimit të Strategjive dhe të Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave. Në kuadër të kësaj strategjie, përsa i përket produkteve bujqësore, politikën për mbrojtjen e konsumatorit për periudhën në vazhdim do të bazohen në objektivat e mëposhtëm, të cilët synojnë të përkrahin dhe të forcojnë interesat e konsumatorit në treg. Objektivat kryesorë do të jenë: (i) të rrisim nivelin e mbrojtjes së konsumatorit; (ii) të zbatojmë më me efektivitet rregullat dhe ligjet për mbrojtjen e konsumatorit; (iii) të rrisim shkallën e informacionit, konsultimit dhe edukimit të konsumatorit.

Qëllime

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes. Afrimi i kushteve të punës me standartet e BE-së
- Krijimi i një sistemi modern kontabiliteti brenda vitit 2010.
- Krijimi i një sistemi me funksionim të plotë të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimeve që mbulon të gjithë vendin dhe monitorim, kontroll bashkëkohor në përputhje me standartet e BE-së deri në 2012 për rritjen e nivelit të mbrojtjes së konsumatorit.
- Rritja e prodhimit bujqësor nëpërmjet plotësimit të nevojave të fermerëve për ujë dhe përmirësimin e kullimit dhe mbrojtjes nga përmytjet të tokave bujqësore. Pavarësi e plotë e shoqatave të përdorimit të ujit dhe bordeve të kullimit në procesin e operimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të transferuara.

- Arritja e progresit teknologjik dhe rritja e prodhimit nga bujqësia, blektoria dhe agropërpunimi.
- Ngritja e cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së Qendrave Rajonale të Transferimit të Teknologjive Bujqesore. Numri i projekteve të kërkimit i përputhur me nevojat në rritje të përfituesve (90% e projekteve do të ketë natyrë të tillë). Rritja sasiore dhe cilësore e treguesëve statistikor të sistemit të bujqësisë në funksion të të interesuarve.
- Përfundimi i ndarjes së tokës, i akteve të dhënies së tokës në pronësi, krijimi i titujve të pronësisë duke krijuar premisat e një zhvillimi dinamik të tregut të tokës. Krijimi i bazës dokumentare të kadastrës së shumëqëllimshme për arritjen e një administrimi të qëndrueshëm në kushtet e privatizimit të tërësishëm të tokës bujqesore. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit të sistemit të informacionit tokësor. Mbrojtja e fondit të tokës bujqesore bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Sigurimi i fondeve dhe drejtimi i tyre në zonat rurale për realizimin e planeve të veprimit në rajonet pilote.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionit të MBUMK-se nëpërmjet kapaciteteve të drejtimit për implementimin e politikave që përafrojnë bujqesinë, veterinarinë dhe ushqimin me standartet e BE-se. Të forcohet përdorimi i burimeve (njerezore dhe monetare) të ministrisë, zhvillimi i vazhdueshëm i procesit të trajnimit të administratës publike dhe nga Institutet Nderkombëtare ku në aderojmë, reduktimi i nivelit të shpenzimeve dytesore.

3.2 SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimeve dhe përafrimi i tyre me ato të BE-se, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit shqiptar dhe në rritjen e sigurisë ushqimore të produkteve shqiptare në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

3.3 MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË KULLIMIT DHE UJITJËS

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e politikave kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga permbytja. Përmirësimin dhe rritjen e menaxhimit, ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga permbytja.

3.4 MBËSHTETJA E PRODHIMIT BUJQESOR, BLEGTORAL, AGROINDUSTRIAL DHE MARKETINGU

Politika e këtij programi konsiston në krijimin e mjedisit për modernizimin dhe përmirësimin e procesit teknologjik, rritja e prodhimit të produkteve ushqimore përmes cilësive dhe infrastruktures së marketingut, mbrojtjen e resurseve gjenetike dhe zhvillimit të racave të reja. Bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare në lidhje me politikën e marketingut. Plotësimin e kuadrit ligjor.

3.5 KESHILLIMI DHE INFORMACIONI BUJQËSOR

Politika e këtij programi konsiston në realizimin në vazhdimësi të transferimit të teknologjive (kryesisht në formën e kërkimit në ferme), mbështetjen e shërbimeve të ekstensionit dhe agrobiznesit me ekspertizë teknike për të siguruar prodhim bujqësor të qëndrueshëm, eficient dhe me leverdi. Sigurimin nga strukturat e ekstensionit i asistencës teknike dhe ekonomike për fermerët. Rritjen e qëndrueshme të të ardhurave të fermerëve privat. Sigurimin e të dhënave statistikore me besueshmëri të lartë (në përputhje me standartet e Eurostat-it) për sistemin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3.6 MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I TOKËS BUJQËSORE

Politika e këtij programi konsiston në administrimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, në krijimin e sistemit të informacionit mbi tokën bujqësore.

3.7 ZHVILLIMI I INTEGRUAR RURAL

Politika e këtij programi konsiston në mbështetjen financiare për përmirësimin e cilësive së jetes në zonat rurale dhe nxitjen e aktiviteteve të shumëllojshme ekonomike përmes: rritjes së aftësive konkurruese të sektorit bujqësor dhe agro-ushqimor, mbrojtjes së mjedisit duke mirë menaxhuar në mënyrë të vazhdueshme burimet natyrore të tokës, mbështetjes për rritjen e kapaciteteve të institucioneve për të planifikuar, menaxhuar dhe bashkërenduar efektivisht aktivitetet në mbështetje të zhvillimit rural.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përfaqësojnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Organizimi i trainimeve për stafin e ri në masën 50% dhe për stafin ekzistues në masën 35%
- Supervizimi i trainimit 100% të stafit që merret me financat dhe kontabilitetin e MBUMK

Produktet që do të ofrohen

- Trajnimi dhe asistencë teknike për ndertimin e kapaciteteve
- Kompletim i zyrave me pajisje kompjuterike dhe trajnim i personelit
- Sistemi i pagesave funksional
- Sistemi i IT-se në funksion të plotë

4.2 SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT

Objektivat e politikës

- Ngritja e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU)
- Program për monitorimin e mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet ushqimore me origjinë shtazore
- Përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore, program për kontrollin e sëmundjeve zoonotike
- Program monitorimi për molusqet dhe ujrat
- Program i identifikimit të kafsheve dhe regjistri i fermave blegtorale. Emergjencat për sëmundjet infektive (influenca, aftë epizotike etj) dhe eliminimi i kafsheve.
- Program për luftimin e parazitëve të vecantë të bimeve në bujqësi
- Program për krijimin e zonave të mbrojtura, krijimi i sistemit të shpejtë të informimit

Produktet që do të ofrohen

- Situata epidemiologjike nën kontroll për sëmundjet zoonotike të mbështetura nga shteti.
- Shërbimi i kontrollit në bujqësi
- Mbeshtetja e administratës rajonale të bujqësisë dhe ushqimit (vazhdimësia e aktivitetit të DRBU-ve duke pasur si qëllim motivimin e punonjësve)
- Monitorim i mbetjeve në kafshët e gjalla e produkteve me origjinë shtazore
- Laboratore efikente (laboratore të pajisur me mjetet dhe stafin e nevojshëm me qëllim rritjen e sigurisë ushqimore në vend)
- Shpende të vaksinuar

4.3 MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË KULLIMIT DHE UJITJËS

Objektivat e politikës

- Rehabilitimi dhe permiresimi i infrastruktures se ujitjes per 10000 ha dhe infrastruktures se kullimit dhe mbrojtjes nga permbytja per 25 000 ha
- Rehabilitimi i 15 digave
- Rehabilitimi i 2 hidrovoreve te Gorrices ne Vlore dhe Butrintit ne Sarande
- Konsolidimi i pergjegjesive te operimit dhe mirembajtjes te infrastruktures ujitesse te transferuar shoqatave te perdoruesve te ujit ne 250 000 ha
- Minimizimi i pertmbytjeve ne zonen e Lezhes nepermjet hapjes se grykederdhjes ne det te lumit Drin i Lezhes
- Funksionimi sipas kushteve teknike te 28 hidrovoreve per sigurimin e kullimit te 75 000 ha toke me sistem kullimi me ngritje mekanike
- Konsolidimi i pergjegjesive te operimit dhe mirembajtjes te sistemeve te kullimit e mbrojtjes nga permbytja nga 16 Borde Kullimi ne 280 000 ha

Produktet qe do te ofrohen

- 25000 ha toke bujqesore me rrjet kullues te rehabilituar
- 10000 ha toke bujqesore me rrjetin e ujitjes se rehabilituar
- 75000 siperfaqja e tokes bujqesore qe kullojne me hidrovore
- 280 000 ha toke bujqesore (ku perfshihen dhe siperfaqet qe mbrohen nga permbytja me argjinatura dhe KUL) qe kullon me rrjedhje te lire dhe ngritje mekanike e menaxhuar nga 16 Borde te Kullimit
- 250 000 ha toke bujqesore e ujitshme e menaxhuar nga shoqatat e perdoruesve te ujit
- 2 hidrovore te rehabilituara plotesisht
- 15 rezervuar te rehabilituar

4.4 MBËSHTETJA E PRODHIMIT BUJQESOR, BLEGTORAL, AGROINDUSTRIAL DHE MARKETINGU

Objektivat e politikës

- Fillimi i ngritjes se kadastres se vreshtarise dhe veres, mbeshtetje per prodhimin e fidaneve ne zbatim te permiresimit gjenetik te germoplazmes se hardhise
- Rritja e burimit te kreditimit per agroindustrine, mbeshtetje per ngritjen e linjave te perpunimit te fruta-perimeve si dhe per lidhjen e grupeve te fermereve dhe te shoqatave agroperpunuese
- Rritja e resurseve gjenetike ne ferma dhe nxitja e zhvillimit te bimeve dhe te racave te reja. Mbeshtetje per mbrojtjen e races autoktone te buajve ne zhdukje ne rrethet Fier, Tirane, Elbasan rreth 140 krere
- Investime per ngritjen e tregjeve me shumice dhe thertoreve (5 thertore dhe 2 tregje) (ASP dhe FAO), Mbeshtetja e promovimit te produkteve bujqesore dhe industrise ushqimore me ane te pjesemarrjes ne panaire kombetare dhe nderkombetare, ekspozim ne 5 panaire kombetare dhe pjesemarrja ne panaire brenda vendit. Harmonizimi gradual i rregullores se BE-se nr.1493/99

Produktet qe do te ofrohen

- 5 thertore te reja te ndertuara
- Ngritja e kadastres se vreshtarise dhe veres
- 7 ambjente te ndertuara per grumbullimin, ruajtjen dhe manipulimin e patateve ne Kukës

- 2 pajisje te reja per perpunimin e fruta-perimeve
- Pjesemarrje ne 5 panaire nderkombetare dhe 4 panaire kombetare
- Pjesemarrja e fermereve ne aktivitetet e tregut
- Markimi dhe etiketimi i duhanit ne tregun shqiptar

4.5 KESHILLIMI DHE INFORMACIONI BUJQËSOR

Objektivat e politikës

- Permiresimi dhe gjenerimi i teknologjive te reja, kryesisht nepermjet kerkimeve ne ferme (mesatarisht 35 projekte ne vit) Konsolidimi i 5 Qendrave te Transferimit te Teknologjive Bujqesore, ne perputhje me politiken e MBUMK-se per ristrukturimin e Rrjetit te Kerkimit Bujqesor ne varesi te saj.
- Percaktimi i struktures dhe llojeve me te pershtatshme per kushtet agro-ekologjike te vendit, sigurimi per disa kultura i materialit parabaze si dhe ofrimi i sherbimeve te tjera. Sigurimi i aksesit per informacion per fermeret dhe aktore te tjere te interesuar te sistemit bujqesor, nepermjet ngritjes dhe mirefunksionimit te Qendrave te Informacionit Bujqesor ne te gjithe vendin (nga 110 vetem 60 Qendra jane te pajisura). Permiresimi i aftesive dhe njohurive te specialisteve te bujqesise dhe fermereve, nepermjet trajnimit te tyre (130 dite trainim ne vit per specialistet dhe 600 dite ne vit per fermeret).
- Pjesemarrja dhe mbulimi i kosos nga fermeret ne aktivitetet e ekstensionit (kerkime ne ferme demonstrime, dite-fushe, trainime, shitja e materialeve te ekstensionit etj.) (rreth 20%)
- Garantimi i cilesise dhe saktesise se te dhenave te mbledhura nepermjet vezhgimeve fushore
- Grumbullimi, perpunimi, analizimi, publikimi dhe administrimi i te dhenave statistikore te sistemit te Bujqesise dhe Ushqimit
- Rritja e kapaciteteve institucionale te sherbimit statistikor

Produktet qe do te ofrohen

- 15 teknologji te reja te gjeneruara / permiresuara te zbatuara ne fushen e bujqesise dhe blegtorise
- 20 projekte kerkimi ne ferme te zbatuara ne fushen e bujqesise dhe blegtorise
- 5 Qendra te Transferimit te Teknologjive Bujqesore me infrastrukturën e nevojshme te permiresuar
- 10-15 lloje me te pershtatshme te bimëve dhe kafshëve te testuara dhe rekomanduara nga QTTB-të
- 10-15 lloje te materialit mbjellës te hallkave te larta ne fara (shumëzim i linjave komponente prindërore) prodhuar dhe ofruar nga QTTB-të
- 15-20 qendra te reja te Informacionit Bujqësor te pajisura me infrastrukturën e nevojshme
- 60 000 fermerë te kontaktuar direkt ne aktivitetet e ekstensionit ku sigurohet perfshirja e te interesuarve ne kete proces, permiresimi i shprehive praktike dhe njohurive te fermerëve te interesuar
- 45 fushata mediatike (TV, radio, libra/broshura dhe materiale te ndryshme informative)per te percjelle mesazhe ekstensionit ku sigurohet perfshirja e te interesuarve ne kete proces dhe behet e mundur mbulimi i pjesshem i kosos, permiresimi i shprehive praktike dhe njohurive te fermerëve te interesuar
- 10 lloje te materialit mbjellës te hallkave te larta ne fidane, te prodhuar dhe ofruar nga QTTB-të

- Vjetari statistikor për bujqësi dhe agroperpunimin
- Revista "Bujqësia shqiptare" 12 numra dhe Buletini i shkencave bujqësore (3-4 numra)

4.6 MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I TOKËS BUJQËSORE

Objektivat e politikës

- Përfundimi i ndarjes së tokës
- Ngritja e kapaciteteve ekzistuese të administrimit të tokës
- Venia në funksionim e strukturave të mbrojtjes së tokës

Produktet që do të ofrohen

- Sistemi i qëndrueshëm i menaxhimit të tokës

4.7 ZHVILLIMI I INTEGRUAR RURAL

Objektivat e politikës

- Planifikimi dhe zbatimi i projekteve pilote rajonale të zhvillimit si dhe zhvillimin e kriterëve për zgjedhjen e zonës premtuese pilote për zhvillimin rural
- Rritja e kreditimit në masën 6% në zonat rurale për mekanizimin, frutikulturën dhe inputet
- Identifikimi dhe zgjedhja e zonës premtuese për zhvillim

Produktet që do të ofrohen

- Përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat malore mbështetjes financiare

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, million Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore 600, 601	Mallra dhe sherbime 602	Subveconet 603	Te tjera transferte korrente 604, 605	Transferta per buxhetet familiare dhe individet 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	120	53	0	12	0	2	187
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	649	381	0	0	0	308	1 338
Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	0	0	450	0	0	1 912	2 362
Mbeshtetja e prodhimit bujqesor blegtoral agroindustrial dhe marketingu	10	20	0	0	400	564	994
Keshillimi dhe informacioni bujqesor	109	30	0	0	0	120	259
Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore	15	2	0	0	0	0	17
Zhvillimi integruar rural	0	0	0	0	0	359	359
Total	903	486	450	12	400	3 265	5 516

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes		
Toke bujqesore me rrjet kullues te rehabilituar	ha	25 000
Toke bujqesore me rrjetin e ujitjes se rehabilituar	ha	10 000
Siperfaqja e tokes bujqesore qe kullojme me hidrovore (e perfshire ne totalin e siperfaqes kulluese prej 280 000 ha)	ha	75 000
Siperfaqja e tokes bujqesore qe mbrohet nga permytjet lumore dhe detare e perfshire ne siperfaqen totale prej 280 000 ha te kullimit e mbrojtjes nga permytja qe menaxhohen nga 16 Bordet e Kullimit	ha	130 000
Siperfaqe ujitese e tokes bujqesore e menaxhuar nga shoqatat e perdoruesve te ujit	ha	250 000
Siperfaqe kulluese dhe e mbrojtur nga permytja e tokes bujqesore e menaxhuar nga 16 bordet e kullimit	ha	280 000
Hidrovore te rrehabilituara	Hid.	2
Diga te rrehabilituara	Dig.	15
Mbeshtetja e prodhimit bujqesor blegtoral agroindustrial dhe marketingu		
Ambjente te ndertuara per grumbullimin, ruajtjen dhe manipulimin e patateve ne Kukës		7
Pajisje te reja per perpunimin e fruta-perimeve		2
Etiketimi i duhanit ne tregun shqiptar		
Keshillimi dhe informacioni bujqesor		
Teknologji te reja te gjeneruara /përmirësuar (kërkimi i aplikuar) te zbatuara ne fushen e bujqesise dhe blegtorise		15
Projekte kerkimi ne ferme te zbatuara ne fushen e bujqesise dhe blegtorise		20
Lloje me te pershtatshme te bimëve dhe kafshëve te testuara dhe rekomanduara nga QTTB-të		15
Lloje te materialit biologjik te hallkave te larta ne fara (shumëzim i linjave komponente prindërore) prodhuar dhe ofruar nga QTTB-të		15
Lloje te materialit biologjik te hallkave te larta ne fidana te rigjeneruar, prodhuar dhe ofruar nga QTTB-të		10
Qendra te reja te Informacionit Bujqësor te pajisura		20
Fermerë te kontaktuar direkt ne aktivitetet e ekstensionit		60 000
Vjetari statistikor per bujqesisne dhe agroindustrine	nr	1
Revista "Bujqesia shqiptare"	nr	12
Buletini i shkencave bujqesore	nr	3

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999, “Për ujitjen dhe kullimin”

“Për disa ndryshime në ligjin nr. 9362, datë 24.03.2005, “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”

“Për materialin mbjellës bimor”

“Për disa ndryshime në ligjin nr. 9426, datë 06.10.2005, “Për mbarështimin e blegtorisë”

Amendimi i Ligjit nr. 8443 date 21.01.1999 “Për vreshtarine, vererat dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rushi

Amendimi i ligjit Nr 9308 date 04.11.2004 “Mbi shërbimin dhe inspektoriatin veterinar”

Ndryshime ne ligjin nr.7501, date 19.07.1991 “Per tokat bujqesore”.

Ndryshime ne ligjin nr. 8312, date 26.03.1998 “Per tokat bujqesore te pandara”

Aneks 2 Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë

Programi i punës për vitin 2007 është përgatitur mbi bazën e Programit të Qeverisë 2005-2009. Ai pasqyron politikën e Qeverisë në fushën e bujqësisë dhe ushqimit në përgjithësi si dhe zhvillimit rural e mbrojtjes së konsumatorit në veçanti. MBUMK linjën kryesore të veprimit do ta shtrijë këtë vit në drejtim të përmirësimit dhe rritjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral, në agroindustri e agroturizëm të shoqëruar nga një marketing që do të tentojë drejt standarteve. Rezultatet e punës për 2007 që lidhen me programin e Qeverisë janë si mëposhtë vijon:

Angazhimet e Programit të Qeverisë
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi
Përfundimi i hartimit të Staregjisë Sektoriale të Zhvillimit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural dhe Strategjisë së Mbrojtjes së Konsumatorit për Produktet Ushqimore”.
Përfundimi i Planit të Veprimit për Bujqësinë Organike, prodhimin organik dhe sistemet e tij në lidhje me cilësinë ushqimore.
Ngritja e sistemit të monitorimit të implementimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Rural si dhe Strategjive sektoriale.
Përfundimi i hartimit të ligjit për “Materialin mbjellës bimor”, përfundimi i disa plotësimeve në kuadrin ligjor për ujitjen dhe kullimin, për shërbimin e mbrojtjes së bimëve, për mbarështrimin e blegtorisë, për tregëtimin e farërave të drithërave dhe bimëve foragjere, për tregëtimin e materialit të shumëzimit të bimëve drufrutore, mbi normat e grumbullimit të qumështit të papërpunuar, mbi kërkesat teknike të qumështit të papërpunuar që përdoret për qumështin e trajtuar termikisht dhe në prodhimin e produkteve me bazë qumështi, mbi kërkesat për përmbajtjen mikrobike në qumështin e konsumit dhe të produkteve me bazë qumështi, mbi përbërjen dhe treguesit cilësor të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi.
Realizimi totalisht i fondeve buxhetore për të gjithë institucionet vartëse, ulja e shpenzimeve, rritja e efektivitetit dhe transparencës në përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe lufta kundër korrupsionit.
Hartimi i Projekt-Buxhetit 2008, ku do të reflektohen politikat në mbështetje të prodhimit bujqësor, blegtoral dhe agroindustrial. Do të përgatitet buxheti afatmesëm 2008-2010, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe konsulentët e huaj duke patur si bazë politikat orientuese të programit të qeverisë.
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit
Plotësimi i normave dhe standarteve të cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe interesave të konsumatorit, sigurimin e një konkurrence të ndershme në treg dhe futjen e produkteve ushqimore në tregun ndërkombëtar.
Përfundimi i hartimit të rregulloreve për sheqerin, mjaltin, kontaminuesit në ushqime, kushtet sanitaro-veterinare dhe çertifikimin veterinar për eksportin e peshqve të gjallë, për standartet minimum të kafshëve shtëpiake. Do të bëhet rregjistrimi i subjekteve eksportuese, importuese, prodhuese dhe tregëtuese për vitin 2006.
Kontrolli dhe monitorimi i zbatueshmërisë së ligjit në subjektet prodhuese, grumbulluese, përpunuese dhe tregtuese, të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi.
Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujitjes
Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes për 10000 ha si dhe infrastrukturës së kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja të një sipërfaqe prej 25.000 ha, si dhe minimizimi i përmytjeve në zonën e Lezhës nëpërmjet hapjes së grykëderdhjes në det të lumit Drin të Lezhës dhe në zonën e Fierit nëpërmjet zgjerimit të magjstralit të Roskovecit.
Mbështetja e prodhimit bujqësor blegtoral agroindustrial dhe marketingu
Rritja e sipërfaqes me vreshta, pemë frutore dhe ullinjë përmes zbatimit me efikasitet të skemës mbështetëse në vreshtari, pentari dhe ullishte.
Nxitja dhe promovimi i ngritjes së kooperativave (shoqatave) të prodhuesve me qëllim tregëtimin e produkteve të tyre.
Përfundimi i ngritjes së tregut të madh të Gjirokastrës dhe Beratit si dhe therrtoreve në Shkodër dhe Elbasan. Kompletimi dhe paisja e tregjeve dhe therrtoreve të sapondërtuara.
Ngritja dhe funksionimi i Komisionit Qendror të Degustimit të Verërave, vënia në funksionim e Komitetit të Ekspertëve të Qumështit.
Strukturimi dhe mbajtja e “Rregjistrimit Kombëtar të Grumbulluesve dhe Përpunuesve të Qumështit”
Grumbullimi, pasqyrimi dhe analizimi i të dhënave agro-ekonomike të prodhimit bimor, blegtoral, agropërpunimit dhe marketingut për vitin 2006, për evidentimin e tendencave të prodhimit bimor.
Përfundimi i vlerësimit dhe përcaktimit të firove teknologjike në industrinë ushqimore si dhe hartimi i rregullit

<p>teknik të prodhimeve të reja ushqimore.</p>
<p>Realizimi i dy studime për rajonet dhe mikrorajonet potenciale të zhvillimit të pemëve frutore dhe ullirit dhe për vreshtat, si dhe studimi për mbështetjen e fermerëve, grumbulluesve dhe përpunuesve nëpërmjet llogaritjes së TVSH-së zinxhir.</p>
<p>Përfundimi i studimit për përcaktimin e treguesve cilësorë të vajrave të Ullirit dhe Verërave të prodhuara në vend sipas zonave të prodhimit të lëndëve të para për sezonin 2005-2006.</p>
<p>Mbajtja nën kontroll e gjendjes fitosanitare të bimëve dhe produkteve bimore nga parazitët, njohja dhe vlerësimi i situatave fitosanitare brenda dhe jashtë Shqipërisë, kontrolli i përdorimit të PMB-ve për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve si dhe mbrojtjen e mjedisit.</p>
<p>Mbajtja në kontroll e gjendjes së sëmundjeve në kafshë dhe ndjekja nga afër situata epizootike e vendit, duke rritur bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtar.</p>
<p>Keshillimi dhe informacioni bujqësor</p>
<p>Rritja e efektivitetit të shërbimit këshillimor, transferimi i teknologjive bujqësore, plotësimi i nevojave të përdoruesve me informacionin e nevojshëm dhe me besueshmëri të lartë.</p>
<p>Rritja e rolit dhe efektivitetit të QTTB-ve, në mbështetje të shërbimeve të ekstensionit dhe agrobiznesit me ekspertizë teknike për të siguruar prodhim bujqësor të qendrueshëm, eficient dhe me leverdi.</p>
<p>Menaxhimi qendrueshem i tokës bujqësore</p>
<p>Monitorimi i procesit të ndarjes së tokës në zonat e papërfunduara dhe konsolidimi i pronësisë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>
<p>Zhvillimi integruar rural</p>
<p>Përfundimi i studimit pjesor të identifikimit të pikave agroturistike të zonës Farkë-Petrelë-Baldushk, si dhe realizimi i studimeve për zhvillimin e turizmit në dy akse të tjera të zonës përreth Tiranës.</p>
<p>Realizimi në 6-mujorin e dytë të dy studimeve për zhvillimin e turizmit në zonën malore të Korçës dhe në zonën agroturistike Shkodër-Malësi e Madhe.</p>

Aneks 3 Rezultate që lidhën me integrimin European

- Përmirësimi i kuadrit ligjor (ligje, akte nënligjore si dhe udhëzimeve e rregulloreve) ku pjesa më e madhe e të cilave do të synojnë në përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së, të cilat do të rregullojnë fusha të ndryshme veprimi. Në këtë kuadër një vend të veçantë do të zërë përmirësimi i paketës ligjore në fushën e prodhimit bimor, blegtoral, agropërpunimit dhe marketingut në përputhje me direktivat e BE-së. Do të përgatiten V.K.M-të për qumështin, do të hartohet rregullorja për krijimin e “Rregjistrit për Vreshtarinë dhe Verën”, si dhe rregullorja “Për Emërtimin dhe Mbrojtjen e Origjinës të Produkteve Ushqimore”.
- Përafrimi i standarteve aktuale me ato të BE-së, të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, mbrojtjes së mjedisit, sistemit të kontrollit dhe inspektimeve si dhe zhvillimi i infrastrukturës administrative me qëllim zbatimin e legjislacionit si pjesë e politikës së shëndetit të kafshëve që rrjedh nga detyrimet e MSA-së dhe Partneritetit European;

Aneks 4 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	
Blerje pajisje laborator i ushqimit ISUV , Tirane	10
Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	
Thellimi, zgjerimi, disiplinimi i lumit Drin I Lezhes-Lezhe	60
Pastrimi i kolektorit Roskovec-Hoxhare-Fier	30
Sistemi kullues zona Lushnje	25
Sistemi kullues zona Berat	6
Sistemi kullues zona Kuçove	5
Sistemi kullues zona Elbasan	13
Sistemi kullues Vurg-Sarande	13
Sistemi kullues Myzeqe-Vlore	8
Kanal kullues Llakatund-Armen-Vlore	9
Punime kullimi ne lumin Devoll-Korçe	8
Riparim dhe ndertim argjinature te lumit Kir	40
Argjinatura lumit Mat krahu i majte Milot-Fushe Milot-Lezhe	43
Ndertim penela lumi Seman-Fier	15
Ndertim argjinature ne lumin Shkumbin	15
Argjinatura lumit Droje	6
Ndertim argjinature dhe penele ne lumin Osum	18
Mbrojtje nga lumi Buna	20
Mbeshetja e prodhimit bujqesor blegtoral agroindustrial dhe marketingu	
Projektim tregu rajonal, Berat	2
Vazhdim studimi per rajonizim ne vreshtari, Tirane	3
Studim per ngritjen e kadastres se vreshtaris e verave, Tirane	2
Ndertim tregu rajonal ne Berat	53
Ndertim thertore ne Shkoder	25
Ndertim Thertore ne Leskovik	15
Ndertim Thertore ne Sarande	2
Impiant teknilogjik ne thertore Sarande	10
Impiant teknilogjik ne thertore Krume	8
Blerje pajisje per depon e patates Kukës	36
Keshillimi dhe informacioni bujqesor	
Ndërtim laborator in-vitro QTTB Vlorë	3
Rikonstruksion stalle (Bag.Imta) QTTB Korçë	3
Ndertim zyresh, laborator dhe rregullim teritori per departamentin e toka ujrave QTTB Fushe-Kruje	97000

Aneks 5 Projekte të ndihmës së huaj

Emri i projektit	Donatori	Kosto totale	Data e mbarimit
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit			
Kontrolli i gripit të shpendeve dhe përgatitjes për parandalimin e pandemisë humane	IDA , PHRD (Granti Japonez)	690	Qershor 2009
Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujitjes			
Menaxhimi i burimeve ujore	IDA, OPEC, Kuwait	4700	2008
Mbeshtetja e prodhimit bujqësor blegtoral agroindustrial dhe marketingu			
Sherbimeve bujqësore	IDA	1184	2007
Rritja e prodhimit ushqimor - 2KR	Qeveria Japoneze	1559	2008
Zhvillimi i integruar rural			
Programi i zhvillimit të zonave malore	IFAD	1360	2007
Programi i zhvillimit të zonave malore	FFAM	37	2007

